REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE**

**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**Nr. 67/2021 (JR)** **Tiranë më 3 .05.2024**

**Nr. 67/2 regj.**

# SHPALLJE
# E
# NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se **ditën e mërkurë, datë 05.06.2024, ora 10:00,** do të shqyrtohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh çështja me nr. regjistri (JR) 67/2021, datë 09.11.2021, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Albert Spiro, kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 419, datë 12.07.2021.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

| | |
|---|---|
| **Kryesues i Trupit Gjykues** | **Sokol Çomo** |
| **Relatore e Çështjes** | **Ina Rama** |
| **Gjyqtare** | **Albana Shtylla** |
| **Gjyqtare** | **Rezarta Schuetz** |
| **Gjyqtare** | **Natasha Mulaj** |

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të paraqesë deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, pika 3 të Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit të çështjes, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

**KRYESUES I TRUPIT GJYKUES**

**GJYQTAR**

**SOKOL ÇOMO**